



NJOFTIM PËR SHTYP
E ngarkuar 10/12/2020, 11:00 CET

PROGRAMI PER 7 ME TE RREZIKUARIT 2021 M

Manastiri i Deçanit në listën e ngushtë ndërmjet 12 vendeve më të rrezikuara të Trashëgimisë në Europë

Hague / Luxembourg, 10 Dhjetor 2020

Europa Nostra – zëri European i shoqërisë civile i fokusuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore – dhe organizata partnere, Instituti i Bankës Europiane të Investimeve, ka shpallur sot 12 vendet më të rrezikuara të trashëgimisë në Europë, që janë në listën e ngushtë të programit për 7 Më të Rrezikuarit 2021:

- [Manastiri Deçanit, KOSOVË](#) * i
- [Hekurudha Achensee Steam, Tyrol, AUSTRI](#)
- [Teatri Modern, Sofia, BULLGARIA](#)ë lokalit
- [Kompleksi i varrezës së Mirogojt, Zagreb, KROACI](#)
- [Kisha e Shën-Denis, Hauts-de-France, FRANCE](#)
- [Fortesa Narikala, Tbilisi, GJEORGJI](#)
- [Sistemi i Zinxhirit të Gjelbër, Köln, GJERMANI](#)
- [Pesë Ishujt e Egjeut Jugor, GREQI](#)
- [Kopështi Giusti, Verona, ITALI](#)
- [Pallati Ca' Zenobio, Venecia, ITALI](#)
- [Posta Qëndrore në Shkup, MAQEDONIA E VERIUT](#)
- [Kapela e Shën Joanit të Sokuevës dhe Hermitazhi, Kantabria, SPANJË](#)

Përzgjedhja është bërë mbi bazën e kuptueshmërisë së trashëgimisë dhe të vlerave kulturore për seicilin nga vendet, si edhe mbi bazën e rrezikut serioz që ata paraqesin. Niveli i lidhjes me komunitetet, me faktorët publikë dhe privatë për të shpëtuar këto vende është konsideruar si një vlerë e shtuar. Një kriter tjetër i zgjedhjes është potenciali i këtyre vendeve për të vepruar si katalizatorë për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik në lokalitetet e tyre dhe më gjërë..

Të 12 vendet më të rrezikuara u përzgjedhën në listën e ngushtë nga një [Panel Këshillimi](#), ku bënë pjesë ekspertë të historisë, arkeologjisë, arkitekturës, ruajtjes, analistë projektesh dhe financash. **Lista finale e 7 vendeve të trashëgimisë Më të Rrezikuar në Europë për vitin 2021 do të shpallet në muajin Mars.**

Me elementin e tij krijues e të kombinuar të shprehjeve artistike Lindore dhe Perendimore, ansambli enciklopedik i afreskave të stilit Serbo-Bizantin dhe të arkitekturës Romanesko-Gotike dhe të dekoracionit skulpturor të Manastirit të Deçanit, është një nga ansamblet më të spikatura të trashëgimisë të kohës së tij. I ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit të 14, ky Manastir i Krishterë Serbo Orthodox është gjithashtu një nga monumentet mesjetare më të ruajtura në Europë. Kompleksi manastirial është i rrethuar nga një pyll i bukur, që formon pjesën e rrethimit të peisazhit kulturor, i cili është i pandarë ngavlerat e larta të trashëgimisë kulturore. Duke qënë i banuar në rreth shtatë shekuj, Manastiri i Deçanit është një manastir që funksionon me shërbime të përditëshme liturgjike dhe me një komunitet aktiv manastirial të përbërë nga 25 murgjër. Ata kujdesohen për mirëmbajtjen e përditëshme të manastirit dhe ambienteve përreth, duke mbrojtur trashëgiminë e jetës manastiriale dhe duke mirëpritur pelegrinët e turistët, që e vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme.

Manastiri i Deçanit është i regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore si monument në vitin 2004. Në vitin 2006, ky status u zgjerua edhe për tre manastire dhe kisha të tjera të Krishtërit Serbo Orthodox, siç është manastiri i Graçanicës, Patriarkana e Pejës dhe Kisha e Virgjëreshës Ljeviš në Prizren. Që nga viti 2006, të katër këto vende janë të regjistruara në Listën e Monumenteve Botërore në Rrezik të UNESCO-s.

ëQë nga Qershori 1999, Manastiri i Deçanit ka qenë 24/7 në mbrojtje nga trupat e paqes së NATO-s dhe KFOR-it. Kjo si pasojë e faktit, sepse manastiri ishte atakuar katër herë nga granata vdekjeprurëse të hedhura nga ekstremistët gjatë periudhës nga viti 1999 deri në vitin 2007, si edhe nga një sulm terrorist nga ISIS në vitin 2016, gjë që shkaktoi dëmtime të riparueshme. Në të njëjtën kohë manastiri dhe zona e tij e mbrojtur paraqesin rrezik të madh të ambientit. Plani lokal hapësinor i bashkise nuk është në përputhje me rregullat strikte të mbrojtjes për një Vend që bën pjesë në Trashëgiminë Botërore të UNESCO-s apo të ligjeve të ngjashme kombëtare dhe rregulloreve. Ka një rrezik të vazhdueshëm nga zhvillimi i pa organizuar i qendrës së banuar, në afërsi të manastirit si edhe rreziku i zënies së tokës në pronësi të Manastirit të Deçanit. Në veçanti është i rrezikshëm, plani për ndërtimin e autostradës kryesore ndërkombëtare, që të kalojë direkt pranë portave të hyrjes në manastir.

Paneli Këshillues i programit për 7 Më të Rrezikuarit shënon: “Ky është i vetmi monument në Europë, që ka një mbrojtje të fortë ushtarake, të vazhdueshme për një periudhë 20 vjeçare. Akoma edhe sot kjo përbën një monument me rëndësi historike dhe kulturore për Europën dhe për botën, ashtu si konfirmohet nga vetë statusi i Trashëgimisë Botërore. Është e rëndësishme që sot, Manastiri i Deçanit dhe trashëgimia e tij kulturore dhe natyrore, si edhe komuniteti manastirial, janë bërë peng i statusit të pazgjidhur të Kosovës*. Për pasojë është urgjente dhe e domosdoshme, që të sigurohet një respektim i plotë i rregullave ligjore për t'i dënë një vëmendje të fortë mbrojtjes së këtij vendi të Trashëgimisë Botërore brenda bisedimeve të vazhdueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Kjo mund të vendoset në një diskutim më të gjërë të nevojës për të siguruar një mbrojtje adekuatë dhe një interpretim të trashëgimisë multikulturore dhe multi-fetare të Kosovës si një parakusht për paqe dhe prosperitet të qëndrueshëm në rajonin e gjerë.”

[E Ardhmja për Trashëgiminë Fetare](#), rrjeti evropian për vendet e historike të adhurimit, i cili është anëtar i [Aleances së Trashëgimisë Europiane](#), nominoi [Monastirin e Deçanit](#) në Programin e 7 Më të Rrezikuarve për vitin 2021.

Presidenti Ekzekutiv I Europa Nostra, **Prof. Dr. Hermann Parzinger**, shënon: “Në një kohë të një krize globale shqetësuese, ne qëndrojmë në solidaritet të plotë me komunitetet lokale në të gjithë Europën, të cilët janë administratorë të palodhur të pasurive tona më të prekshme të trashëgimisë. Ne qëndrojmë në solidaritet dhe gjithashtu qëndrojmë në veprim. Ju mund të mbështeteni në Europa Nostra, dhe rrjetin tonë të gjerë të anëtarëve dhe partnerëve, për të ngritur zërin tonë në mbrojtje të këtyre 12 vendeve të trashëgimisë në rrezik për t'u humbur përgjithmonë. Nga peisazhet natyrore ikonike, të vendet me rëndësi fetare dhe gurët e çmuar arkitektonikë modernistë, këto vende të mrekullueshme mishërojnë historinë tonë të përbashkët dhe janë një burim i pashfrytëzuar zhvillimi dhe mirëqenie për rajonet dhe vendet e përfshira dhe për Europën në tërësi. Në një kohë kur është më e nevojshme, le të punojmë së bashku për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore dhe ta vendosim atje ku i takon: në zemër të rimëkëmbjes post-pandemike të Europës”

Dekani i Institutit të Bankës Evropiane të Investimeve, Francisco de Paula Coelho, thotë: “Kjo listë e ngushtë është një kujtesë e rëndësishme se trashëgimia jonë kulturore është e brishtë dhe se nuk duhet të merret si e mirëqenë. Me këtë listë të ngushtë, qëllimi ynë i përbashkët është të mbështesim dhe të amplifikojmë përpjekjet e komuniteteve lokale të cilët, në të gjithë Evropën, janë të bindur për vlerën e pamasë dhe shumëplanëshe të trashëgimisë sonë kulturore. Në mënyrë që të përfitojmë plotësisht nga trashëgimia jonë e përbashkët kulturore si një nxitës i zhvillimit të qëndrueshëm, ne duhet të sigurojmë ruajtjen e saj fizike si hapin e parë dhe më urgjent”.

Programi 7 Më të Rrezikuarit drejtohet nga **Europa Nostra** në partneritet me **Institutin e Bankës Europiane të Investimeve**. Ai gjithashtu ka mbështetjen e programit **Europa Krijuese** të Bashkimit Evropian. Ky program, i nisur në vitin 2013, është pjesë e një **fushate të shoqërisë civile** për të shpëtuar trashëgiminë e rrezikuar të Europës. Ai ngre vetëdijen, përgatit vlerësime të pavarura dhe propozon rekomandime për veprim. Ndërsa **nuk siguron fonde të drejtpërdrejta**, renditja e një vendi në rrezik shpesh shërben si **katalizator dhe nxitje për mobilizimin e mbështetjes së nevojshme publike ose private**, përfshirë financimin.

Për edicionin e vitit 2021, për herë të parë që nga fillimi i programit, 7 vendet e trashëgimisë më të rrezikuara do të kualifikohen për një Grant të Trashëgimisë së **EIB deri në 10,000 € për seicilin vend**. Granti i Trashëgimisë së EIB mund t'u caktohet 7 vendeve më të rrezikuara të zgjedhura për t'u ndihmuar në zbatimin e një aktiviteti të rënë dakord që do të kontribuojë në shpëtimin e zonës së kërcënuar.

Nominimet për Programin e 7 më të Rrezikuarve 2021 u paraqitën nga organizatat anëtare, organizatat e asociuara dhe anëtarët individualë të Europa Nostra nga e gjithë Europa si dhe nga anëtarët e [Aleances së Trashëgimisë Europiane](#).

KONTAKTET PËR SHITYP

Europa Nostra
Joana Pinheiro, jp@europanostra.org

PËR MË TEPËR

Për seicilin nga vendet e listës së ngushtë:
[Information and experts' comments](#)

M. +31 6 34 36 59 85
Sara Zanini, sz@europanostr.org
M. +39 32 80 45 58 65

Europa Nostra Serbia

Prof. Dr. Irina Subotić, predsednica
irinasubotic@sbb.rs

[Photos & Video](#) (in high resolution)
[Press release in various languages](#)
www.europanostr.org
www.7mostendangered.eu
<http://europanostraserbia.org>

European Investment Bank Institute

Bruno Rossignol, bruno.rossignol@eib.org
T. +352 43 797 07 67; M. +352 62 134 58 62

<http://institute.eib.org>

Future for Religious Heritage

info@frh-europe.org

<https://www.frh-europe.org/>

Information mbështetës

[Europa Nostra](#) është zëri evropian i shoqërisë civile i përkushtuar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Një federatë pan-Evropiane e OJQ-ve të trashëgimisë, e mbështetur nga një rrjet i gjerë organesh publike, kompani private dhe individë, ajo mbulon më shumë se 40 vende. E themeluar në vitin 1963, sot njihet si rrjeti më i madh dhe më përfaqësues i trashëgimisë në Europë.

Europa Nostra bën fushata për të shpëtuar monumentet, vendet dhe peizazhet e rrezikuara të Evropës, në veçanti përmes [Programit të 7 Më të Rrezikuarve](#). Ajo celebron përsosmërinë përmes [Çmimeve të Trashëgimisë Evropiane/ Çmimeve Europa Nostra](#). Europa Nostra kontribuon në mënyrë aktive në përcaktimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave Evropiane në lidhje me trashëgiminë, përmes një dialogu pjesëmarrës me Institucionet Evropiane dhe koordinimit të [Aleancës së Trashëgimisë Evropiane](#).

The [Instituti i Bankës Evropiane të Investimeve](#) (EIB-I) u krijua brenda Grupit EIB (Banka Evropiane e Investimeve dhe Fondi Evropian i Investimeve) për të promovuar dhe mbështetur iniciativat sociale, kulturore dhe akademike me aktorët evropianë dhe publikun në përgjithësi. Është një shtyllë kryesore e komunitetit dhe angazhimit të qytetarisë së Grupit EIB. Për më shumë informacion shih <http://institute.eib.org>

[Europa Krijuese](#) është një program i BE-së, që mbështet sektorët kulturorë dhe krijues, duke u mundësuar atyre të rrisin kontributin e tyre në vendet e punës dhe rritjen ekonomike. Me një buxhet prej 1.46 miliardë euro për 2014-2020, ajo mbështet organizatat në fushat e trashëgimisë, artet skenike, artet figurative, artet ndërdisiplinore, botimet, filmin, TV, muzikën dhe lojërat video si dhe dhjetëra mijëra artistë, profesionistë kulturorë dhe audiovizivë. Financimi i lejon ata të veprojnë në të gjithë Evropën, për të arritur audiencë të reja dhe për të zhvilluar aftësitë e kërkuara në epokën dixhitale.

ⁱ * Ky emërtim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.